



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2017, merr këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E MEMORIALIT
PËRKUJTIMOR PËR USHTARËT BRITANIK TË KFOR-IT

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e memorialit përkujtimor për ushtarët britanik të KFOR-it, në sheshin „Zahir Pajaziti” në Prishtinë.
- II. Lokacioni për vendosjen e memorialit përkujtimor kushtuar ushtarëve britanik të KFOR-it, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 6204-0 ZK. Prishtinë, në pronësi - pronë shoqërore e Kuvendit Komunal Prishtinë.
- III. Ky vendim paraqet bazë për lejimin e vendosjes së memorialit përkujtimor për ushtarët britanik të KFOR-it.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa grafike – skica e lokacionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. 353/01-0245934/17, më 02.10.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur.i dipl.